



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I BASENIT LUMOR MAT**

**VENDIM**

Nr.8, datë 11.11.2025

**PËR**

**SHTYRJEN E VENDIMARRJES SË KËRKESËS PËR LEJE PËR  
PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR PËR QËLLIME  
INDUSTRIALE, TË SUBJEKTIT “ALBCHROME” SH.P.K., ME  
VENDNDODHJE: NJËSIA ADMINISTRATIVE KOMSI, BASHKIA  
BURREL, RRETHI MAT**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore” i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.319, datë 11.06.2025, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujqor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, vendimit nr. 6, datë 12.06.2019 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Basenit Ujqor ” të Këshillit Kombëtar të Ujqit, neni 20 gërma “c”, pas shqyrtimit të kërkesës , Këshilli Basenit Lumor Mat,

**V E N D O S I:**

1. Shtyrjen e vendimarrjes për shqyrtim të mëvonshëm për “kërkesën për leje për përdorim burimi ujqor nëntokësor për qëllime industriale të subjektit “Albchrome” sh.p.k me vendodhje: Njësia Administrative Komsj, Bashkia Burrel, Rrethi Mat, për arsyet e mëposhtme:
  - ZABL të japë informacion më të plotë mbi pronën ku zhvillohet aktiviteti.
  - Të qartësohet nëse subjekti duhet të pajiset me VNM.
2. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektit.

**KRYETARI I KBL MAT**

**TAULANT MALSHI**

